

Hapet gara për hetuesit e Byrosë Kombëtare

Pas emërimit të drejtueses së Byrosë Kombëtare të Hetimit, SPAK hap garën për rekrutimin e hetuesve që do t'i bashkohen njësisë Antikorrupsion.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Ambasadorja amerikane Yuri Kim takoi kreun e SPAK, Arben Kraja dhe drejtuesen e Byrosë, Aida Hajnaj të martën më 8 shtator. Foto: Twitter

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, SPAK, njoftoi të martën hapjen e procedurës së aplikimit për pozicionin hetues pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit, BKH. Pas zgjedhjes dhe emërimit të drejtueses Aida Veizaj, SPAK nis procesin e rekrutimit të hetuesve që do t'i bashkohen Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Sipas njoftimit, kandidatët duhet të kenë përvojë në luftën kundër korrupsionit ose krimin të organizuar, duhet të kenë arsim të lartë policor ose në fushat e drejtësisë dhe të kontabilitetit.

“Sistemi i përzgjedhjes së hetuesve të BKH-së është një proces sfidues mendor dhe fizik, i përgatitur për të gjetur kandidatët më të aftë dhe me integritet. Ata që janë të suksesshëm në procesin e përzgjedhjes do t'i bashkohen një skuadre elitë që mbështet Prokurorët e Prokurorisë së Posaçmë, të cilët do të ndjekin dhe hetojnë veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimin të organizuar,” thuhet në njoftimin e SPAK.

SPAK bëri me dije se kriteret për aplikantët janë aftësitë profesionale, etike dhe integriteti moral, të mos jenë shkarkuar asnjëherë nga detyra apo të mos kenë masë disiplinore në fuqi si dhe të jenë në kushtet e mungesës së konfliktit të interesit.

Të përzgjedhurit do t'i nënshtrohen më pas provimeve me shkrim, testeve të aftësisë fizike dhe intervistave. Ata do t'i nënshtrohen gjithashtu testit të poligrafit si dhe verifikimit të pasurisë dhe të konfliktit të interesit. Aplikimet do të jenë të hapura deri në 29 shtator 2020.



RRETH AUTORIT

Edmond Hoxhaj

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.